FGJK - KGF

Federata e Gjimnastikës e Kosovës

Plani strategjik 2027–2030

Ky plan përcakton drejtimin e zhvillimit të gjimnastikës në Kosovë për periudhën 1 janar 2027 deri më 31 dhjetor 2030.

KORNIZA STRATEGJIKE E FGJK-së 2027–2030





Përputhja dhe përgjegjësitë

Plani strategjik i FGJK-së lidhet me katër drejtimet e Strategjisë Shtetërore për Sport 2025–2030.

Roli	Përgjegjësia në zbatim
Kuvendi	Shqyrton dhe miraton planin strategjik dhe planin financiar në përputhje me statutin.
Bordi Ekzekutiv	Harton dhe paraqet strategjinë; cakton mandatet; mbikëqyr realizimin dhe masat korrigjuese.
Sekretari i Përgjithshëm	Koordinon zbatimin administrativ, financimin, raportimin dhe arkivin e provave.
Sekretari teknik	Koordinon programet teknike dhe regjistrat e sportistëve e profesionistëve, sipas mandatit të shkruar.
Komisionet dhe klubet	Realizojnë edukimin, përzgjedhjen, gjykimin dhe aktivitetet; dorëzojnë provat e realizimit.
Këshilli Mbikëqyrës	Ushtron kontrollin sipas statutit dhe raporton brenda kompetencave të veta.

Drejtimi shtetëror	Kontributi i FGJK-së
Qeverisje e mirë dhe integritet	OS5: përgjegjësi, mbrojtje, transparencë; OS6: financimi.
Performanca në sportin garues	OS2: trajnerë e gjyqtarë; OS3: programi kombëtar; OS4: kushtet dhe garat.
Shoqëri aktive dhe e shëndetshme	OS1: shkolla, klube dhe përfshirje; OS4: hapësira të përdorshme.
Diplomacia publike dhe zhvillimi	OS3: përfaqësim; OS6: partneritete dhe aktivitet pritës; OS4: planifikim i trashëgimisë 2030.

MISIONI I FGJK-së

1

ZHVILLIMI I GJIMNASTIKËS

Të promovojë dhe zhvillojë gjimnastikën në të gjithë Kosovën, duke rritur pjesëmarrjen dhe duke fuqizuar klubet.

2

ZHVILLIMI I SPORTISTËVE

Të krijojë mundësi për identifikimin, zhvillimin dhe avancimin e sportistëve nga niveli fillestar deri te performanca elitare.

3

ZHVILLIMI PROFESIONAL

Të avancojë vazhdimisht trajnerët, gjyqtarët dhe stafin përmes edukimit, licencimit dhe standardeve bashkëkohore profesionale.

4

PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR

Të përfaqësojë Kosovën me dinjitet dhe konkurrueshmëri në garat dhe strukturat ndërkombëtare të gjimnastikës.

VIZIONI I FGJK-së

1

GJIMNASTIKË PËR TË GJITHË

Të krijojmë një mjedis ku fëmijët dhe të rinjtë në mbarë Kosovën kanë mundësi të përfshihen, të zhvillohen dhe të përjetojnë gjimnastikën në mënyrë të sigurt.

2

SPORTISTË TË SUKSESSHËM

Të ndërtojmë një sistem që identifikon dhe zhvillon talentet, duke krijuar sportistë konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

3

PROFESIONALIZËM DHE CILËSI

Të zhvillojmë trajnerë, gjyqtarë dhe staf të kualifikuar, duke zbatuar standarde të larta profesionale dhe ndërkombëtare.

4

FEDERATË E FORTË DHE MODERNE

Të ndërtojmë një federatë të qëndrueshme, transparente dhe të mirëqeverisur, me klube të fuqishme dhe partneritete të qëndrueshme.



VLERAT TONA

PASIONI: Gjimnastikën e zhvillojmë me përkushtim dhe dashuri për sportin, duke frymëzuar sportistët, trajnerët dhe komunitetin për të synuar vazhdimisht përparimin.
PUNA EKIPORE: Besojmë në bashkëpunimin ndërmjet sportistëve, trajnerëve, gjyqtarëve, klubeve dhe Federatës si themel për zhvillim dhe sukses të qëndrueshëm.
BARAZIA: Sigurojmë mundësi të barabarta dhe një mjedis të sigurt e gjithëpërfshirës për pjesëmarrje në gjimnastikë, pa diskriminim dhe me respekt për diversitetin.
RESPEKTI: Veprojmë me respekt, integritet dhe fair-play ndaj sportistëve, trajnerëve, gjyqtarëve, klubeve, partnerëve dhe kundërshtarëve.

Vlerat e FGJK-së përbëjnë themelin mbi të cilin ndërtohet Plani Strategjik 2027–2030 dhe udhëheqin mënyrën se si Federata punon, bashkëpunon dhe synon zhvillimin e gjimnastikës në Kosovë.



FUQITË

Njohja dhe anëtarësimi në strukturat ndërkombëtare të gjimnastikës

Rrjeti ekzistues i klubeve dhe sportistëve

Potenciali dhe talenti i sportistëve të rinj

Përvoja e trajnerëve dhe stafit ekzistues

Bashkëpunimi me institucionet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare

DOBËSITË

Numër i kufizuar i trajnerëve të kualifikuar

Mungesa e gjyqtarëve me licencë ndërkombëtare

Infrastrukturë dhe pajisje të pamjaftueshme në disa klube

Burime të kufizuara financiare dhe varësi nga financimi publik

Numër i kufizuar i klubeve dhe shtrirje jo e mjaftueshme territoriale

Kapacitete të kufizuara administrative dhe profesionale



MUNDËSITË

Programet edukative të World Gymnastics dhe European Gymnastics

Mbështetja nga KOK-u, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë

Rritja e interesimit të fëmijëve dhe të rinjve për gjimnastikë

Hapja dhe zhvillimi i klubeve në qytete të reja

Partneritete me shkolla, universitete, komuna dhe sektorin privat

Digjitalizimi, marketingu dhe promovimi për rritjen e pjesëmarrjes

Kapacitete të kufizuara administrative dhe profesionale

KËRCËNIMET

Financimi i pamjaftueshëm

Largimi i trajnerëve dhe profesionistëve të kualifikuar

Infrastrukturë sportive e pamjaftueshme

Rreziku i lëndimeve

Rritja e kostove të pjesëmarrjes ndërkombëtare

Rënia e interesimit nëse mungojnë mundësitë për zhvillim dhe avancim





OS1: Masovizimi dhe zhvillimi i klubeve

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
Numri i sportistëve, klubeve dhe shkollave aktive	Zgjerimi i pjesëmarrjes përmes shkollave, klubeve dhe gjimnastikës për të gjithë, gjimnastika e meshkrujve dhe me mundësi të barabarta	50% më shumë sportistë aktivë se në 2026; 6 klube të reja aktive;	Sportistë unikë aktivë; klube aktive

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Sportistë kundrejt 2026	+10%	+25%	+40%	+50%
Klube të reja aktive kumulative	1	3	4	6
Mbajtja e sportistëve	≥75%	≥75%	≥75%	≥75%

Plani i veprimit për OS1

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
1.1 Regjistri dhe harta e nevojave	Mblidhen të dhënat nga të gjitha klubet anëtare; dhe përcaktohen komunat prioritare.	SP; mbështet ST dhe klubet	31.03.2027; përditësim çdo dhjetor	FGJK	100% e klubeve raportojnë; një regjistër bazë i miratuar.
1.2 Gjimnastika në shkolla	Lidhen marrëveshje; çdo shkollë zhvillon 8 seanca të mbikëqyrura në vit dhe referon fëmijët te klubi pritës.	ST; klubet dhe shkollat	Deri më 30.11 çdo vit 2027–2030	Komuna; shkolla; FGJK	3/6/9/12 shkolla sipas vitit; regjistra të 8 seancave për shkollë.
1.3 Mbështetja e klubeve të reja	Përzgjidhet një iniciativë në vit; jepen mentorim, paketë fillestare dhe kontroll i kushteve para hapjes. Perparsi kanë disiplinat e reja jashta gjimnastikës artistike.	SP; klubet dhe komunat	Hapje deri 30.06; verifikim 31.12 çdo vit	FGJK; komuna;	6 klube të reja aktive deri më 2030; secili ≥15 sportistë dhe ≥6 muaj punë.
1.4 Përfshirja dhe qasja	Zhvillohen programe rekreative të përshtatura me partnerë; zgjidhen pengesat financiare dhe të qasjes.	Klubet dhe partnerët	30.11 çdo vit	FGJK;	2 programe nga 8 seanca dhe ≥30 pjesëmarrës unikë në vit.
1.5 Aktivitetet të hapura	Organizohen ditë të hapura me regjistrim paraprak dhe ndjekje të interesimit pas 30 ditësh.	ST; klubet	Qershor dhe tetor çdo vit	FGJK; klube; vullnetarë	4 aktivitete dhe ≥100 pjesëmarrës unikë në vit; ≥20 kalojnë në stërvitje të rregullt.



OS2: Zhvillimi i trajnerëve dhe gjyqtarëve

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
0 gjyqtarë ndërkombëtarë të gjimnastikës artistike dhe 1 trajnim gjyqtarësh në vit sipas rastit 3.	Krijimi i një rruge kombëtare nga kandidati te trajneri ose gjyqtari aktiv, me mentorim dhe transferim të njohurive ndërkombëtare.	20 trajnerë të rinj aktivë deri më 2029 dhe 25 deri më 2030; 12 gjyqtarë aktivë, 4 të avancuar; 2 kandidatë të përgatitur për FIG; synohet ≥1 licencë ndërkombëtare.	Trajnerë të rinj aktivë; mbajtje ≥80% pas 24 muajsh; gjyqtarë aktivë; praktika; licenca FIG të fituara.

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Trajnerë të rinj aktivë kumulativë	10	15	20	25
Trajnime kombëtare për trajnerë	2	4	4	4
Gjyqtarë kombëtarë aktivë	6	8	10	12
Gjyqtarë të avancuar	1	3	6	6

Plani i veprimit për OS2

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
2.1 Regjistri dhe standardet kombëtare	Përcaktohen rolet, tri nivelet e trajnerëve, nivelet e gjyqtarëve dhe kriteret e praktikës e rinovimit.	ST; komisionet; BE	30.06.2027	FGJK; ekspertë; administratë	2 rrugë profesionale të dokumentuara dhe 100% e personelit të regjistruar.
2.2 Rekrutimi dhe mentorimi i trajnerëve	Thirrje vjetore; praktikë 3 deri 6 muaj dhe vlerësim para aktivizimit.	ST; klubet dhe ligjeruesit	Thirrje 31.03; vlerësim 30.09 çdo vit	FGJK; fakultete; klube	≥8 aplikantë/vit; ≥4 të rinj/vit; zëvendësim i largimeve për 25 aktivë në 2030; mbajtje ≥80%.
2.3 Edukimi kombëtar i trajnerëve	Kurse me teori dhe praktikë për sigurinë, metodikën, planifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.	ST; edukatorë vendorë e të huaj	Qershor/dhjetor 2027; çdo tremujor nga 2028	FGJK; KOK; ekspertë	2 kurse në 2027; 4/vit më pas; ≥20 pjesëmarrës/kurs dhe test praktik.
2.4 Edukimi ndërkombëtar dhe transferimi P2	Përzgjidhen 4 trajnerë/vit për akademi ose kampe; raport brenda 15 ditësh dhe trajnim vendor pas kthimit.	ST; SP administron aplikimet	Pjesëmarrje vjetore; transferim brenda 60 ditësh	FGJK; KOK; FIG; EG	2 trajnerë/vit; çdo pjesëmarrës zhvillon 1 trajnim me ≥10 trajnerë/asistentë.
2.5 Shkolla e gjyqtarëve	Rekrutohen kandidatë; realizohen seminar, seanca video, teste dhe gjykim paralel nën mentorim.	KG; ST dhe mentorët	Thirrje mars; program prill–dhjetor çdo vit	FGJK; ekspertë; materiale STS	≥15 aplikantë/vit; 8 seanca/vit; ≥3 praktika/kandidat; 12 aktivë në 2030.
2.6 Përgatitja për licencim FIG	Përzgjidhen 2 kandidatë të avancuar; plan individual, anglishte pune dhe provime provuese; kontrollohet kalendari FIG.	KG; SP dhe BE	Përzgjedhje 30.06.2028; dosje gati 31.12.2029	FGJK; FIG; mentor i jashtëm	2 dosje të gatshme; aplikim në kursin e parë të përshtatshëm; synim ≥2 licencë deri 2030.



OS3: Përmirësimi i rezultateve ndërkombëtare

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
Shembulli 2026 raporton 1 medalje ballkanike, disa finale dhe rreth 2 kampe ndërkombëtare/vit. Rezultatet dokumentohen sipas garës e disiplinës.	Zhvillimi i programit kombëtar të talenteve dhe performancës, me plane individuale, kampe, gara të përshtatshme dhe vlerësim teknik.	≥8 sportistë në program deri më 2030; 4 kampe/vit nga 2028; ≥10 finale dhe ≥8 medalje në gara zyrtare ndërkombëtare gjatë 2027–2030.	Sportistë me plan; kampe; finale dhe medalje sipas nivelit të garës; diferenca ndaj pragut të finales.

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Sportistë në programin kombëtar	≥6	≥6	≥8	≥8
Sportistë me plan individual	100%	100%	100%	100%
Kampe ndërkombëtare në vit	3	4	4	5
Finale kumulative të synuara	≥4	≥6	≥8	≥10
Medalje kumulative të synuara	≥4	≥5	≥6	≥8

Plani i veprimit për OS3

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
3.1 Përzgjedhja dhe planet individuale	Kriteret deri 31.03.2027; dy testime /vit; për çdo sportist caktohen objektivat dhe garat prioritare.	Selektori dhe trajnerët	Plane 30.04.2027; deri 31.01 në vijim	FGJK; trajnerë; klube	≥6 sportistë në 2027 dhe ≥8 në 2030; 100% me plan vjetor.
3.2 Kampet ndërkombëtare	Marrëveshje me partnerë; grup sportistësh dhe trajnerë për çdo kamp; raport teknik dhe plan pas kampit.	Selektori dhe trajnerët	Korrik/nëntor 2027; mars/korrik/nëntor 2028–2030	FGJK; partnerë; KOK	3 kampe në 2027 dhe 4/vit më pas; ≥4 sportistë dhe 1 trajner/kamp.
3.3 Kalendari i garave cilësore	Zgjidhen garat sipas nivelit; konfirmohen pranueshmëria, buxheti dhe pragjet teknike para regjistrimit.	Selektori; ST; SP për logjistikën	Kalendari deri 31.01 çdo vit	FGJK; ministria; KOK	≥3 paraqitje delegacioni/vit; raport brenda 15 ditësh; synohen 6 finale dhe 3 medalje kumulative.
3.4 Monitorimi i performancës	Testim fizik e teknik, analizë video dhe krahasim me planin; korrigjohet përgatitja pas çdo gare.	Selektori dhe trajnerët	Mars, qershor, shtator, dhjetor çdo vit	FGJK; ekspertë;	4 raporte/sportist/vit dhe analizë pas çdo gare; ≥90% testime të planifikuara të kryera.
3.5 Mirëqenia dhe mbështetja profesionale	Sigurohen vlerësime nga profesionistë të kualifikuar; regjistrohen ngarkesa, sjellja dhe mungesat	Selektori, trajnerët dhe profesionistët shëndetësorë	Para sezonit dhe rishikim çdo tremujor	FGJK; shërbime profesionale	100% e sportistëve të programit me dosje të përditësuar dhe 2 sesione edukimi/vit.
3.6 Vlerësimi i rrugës drejt garave madhore	Përgatitet analizë e kritereve dhe diferencës së performancës për Europian, World Cup, LA 2028 dhe ciklin 2030.	Selektori dhe BE	15.02.2027; rishikim pas çdo gare kualifikuese	FGJK;	1 analizë/vit dhe vendim i arsyetuar për programin e garave; dosjet para afateve zyrtare.



OS4: Infrastruktura dhe garat vendore

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
Plani i vjetër evidenton mungesën e hapësirave dhe pajisjeve. Nuk ka sallë adekuata për stërvitje dhe gara të organizuara Brenda vendit.	Sigurimi i hapësirave, pajisjeve të mirëmbajtura dhe garave vendore dhe ndërkombëtare të mbajtura në Kosovë me standarde të njëjta organizimi e gjykimi.	3 palestra gjimnastike; ≥3 gara kombëtare/vit nga 2028 për nivelin A.	Palestra të përmirësuara; kontrolle të dokumentuara; gara të realizuara; rezultate të publikuara në afat.

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Palestra të përmirësuara apo të reja kumulative	1	2	3	4
Gara kombëtare në vit	2	4	4	4
Hapësirë për programin kombëtar	Studim	Marrëveshje	Përdorim	Përdorim
Gara me kontroll paraprak sigurie	100%	100%	100%	100%
Gara ndërkombëtare të organizuara nga FGJK	1	2	2	2

Plani i veprimit për OS4

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
4.1 Auditimi i hapësirave	Inventarizohen palestrat dhe pajisjet e klubeve; caktohet lista e ndërhyrjeve sipas rrezikut dhe përdorimit.	Ekspertët teknik; klubet; BE	30.06.2027; rishikim çdo qershor	FGJK; komuna; ekspertë	100% e hapësirave të raportuara inspektohen; një listë prioritare me kosto.
4.2 Pajisje dhe mirëmbajtje	Përmirësohet një palestër/vit sipas auditimit; regjistrohen pronësia, pranimi dhe përgjegjësi i mirëmbajtjes.	SP dhe klubet	31.10 çdo vit 2027–2030	FGJK; komuna; donatorë apo sponsorë	4 palestra kumulative; 100% e pajisjeve të financuara me evidencë dhe plan mirëmbajtjeje.
4.3 Standardi i garave kombëtare	Zbatohen manual organizimi, plan sigurie, panele gjyqtarësh dhe publikim i rezultateve pas përfundimit.	ST; KG; klubet organizatore	Manual 30.06.2027; kalendar çdo janar	FGJK; klube; gjyqtarë	2 gara të ligës A në 2027 dhe 4/vit më pas; rezultate brenda 7 ditësh në 100% të garave.
4.4 Zgjerimi i disiplinave	Vlerësohen disiplinat statutore jashtë programit kryesor; përzgjidhet një pilot me trajner dhe hapësirë të përshtatshme.	Komisionet	Studim 31.12.2028; pilot deri 30.11.2029	FGJK; klub pritës; ekspert	1 vlerësim; 1 pilot me ≥20 pjesëmarrës dhe 8 seanca; vendim zgjerimi në 2030.
4.5 Propozimi kapital dhe trashëgimia 2030 P3	Përgatitet dosje teknike me kërkesa, kosto dhe shfrytëzim pas ngjarjeve si lojrat Mesdhetare; diskutohet me institucionet përgjegjëse.	Kryetari	Dosje 30.06.2029; rishikim 30.06.2030	FGJK; ministria; komuna	1 dosje dhe ≥2 takime/vit në 2029–2030; realizimi kapital kërkon financim të veçantë.
4.6 Organizimi i turneve ndërkombëtarë të gjimnastikës në Kosovë	Organizimi i turnve nendërkombëtare të gjimnastikës në Kosovë	Kryetari; SP; ST; BE; Komisionet	2027–2030	FGJK; MKRS; KOK; sponsorë dhe pjesëmarrësit	≥1 turne ndërkombëtar i organizuar në Kosovë; pjesëmarrje e sportistëve/klubeve nga ≥5 shtete
4.7 Kandidimi dhe organizimi i Kampionatit Ballkanik të Gjimnastikës 2028 në Kosovë,	Organizimi i Kampionatit Ballkanik të Gjimnastikës, duke përgatitur kandidaturën, buxhetin, kushtet teknike, sallën dhe pajisjet, dhe strukturën organizative	Kryetari; SP; ST; BE; Komisionet	2027 – kandidimi dhe përgatitja; 2028 – organizimi	FGJK; MKRS; KOK; sponsorë dhe pjesëmarrësit	Kandidatura e dorëzuar/miratuar; 1 Kampionat Ballkanik i organizuar në Kosovë në vitin 2028



OS5: Qeverisja e mirë dhe mbrojtja e sportistëve

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
Statuti i 09.03.2025 përcakton qeverisjen, transparencën, privatësinë dhe mbrojtjen e të rinjve.	Përkthimi i parimeve statutore në përgjegjësi të qarta, procedura pune, transparencë financiare dhe kanale të besueshme raportimi.	Raport vjetor publik çdo vit; raportim mujor për planin dhe vlerësim vjetor.	Personel i trajnuar; raporte në afat; masa korrigjuese të mbyllura.

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Klube që zbatojnë Politikën e FGJK-së për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Sportistëve	≥50%	≥75%	100%	100%
Trajnerë dhe personel teknik të trajnuar për mbrojtjen dhe sigurinë e sportistëve	≥50%	≥75%	100%	100%
Raport vjetor public për punen e FGJK-së	1	1	1	1
Përqindja realizuar e aktiviteteve të Planit të Veprimit	≥70%	≥75%	≥80%	≥85%

Plani i veprimit për OS5

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
5.1 Mandatet dhe plani vjetor	Përcaktohen përgjegjësit, komisionet, kalendari i vendimmarrjes dhe lidhja e çdo veprimi me buxhetin.	BE; SP	31.01.2027; plan vjetor deri 15.12 për vitin pasues	FGJK;	100% e veprimeve me përgjegjës të emërtuar; një plan vjetor i miratuar.
5.2 Mbrojtja e fëmijëve dhe raportimi	Miratohet procedura; caktohen përgjegjësit; trajnohet personeli dhe u shpjegohet prindërve kanali i raportimit.	BE; përgjegjësi i mbrojtjes; klubet	Procedurë 30.06.2027; shtrirje 31.12.2028	FGJK;	100% e klubeve deri 2028; raportimet regjistrohen e vlerësohen fillimisht brenda 24 orësh.
5.3 Etika dhe edukimi për integritet	Deklarohen konfliktet e interesit; organizohen sesione për fair play, antidoping dhe sjellje të sigurt.	SP; ST; profesionistë t përkatës	Deklarime çdo janar; edukim qershor /nëntor	FGJK; KOK; ekspertë	100% e vendimmarrësve me deklaratë; 1 sesione/vit; ≥90% e ekipit kombëtar merr pjesë.
5.4 Transparenca dhe kontrolli financiar	Publikohen aktet e raportet për publikun; kryhet shqyrtim financiar vjetor dhe ndiqen rekomandimet.	SP; financieri; Këshilli Mbikëqyrës	Raport deri 31.03 të vitit pasues	FGJK; kontabilitet;	1 raport narrativ e financiar/vit; 100% e masave financiare me afat dhe përgjegjës.
5.5 Administrata dhe zëri i sportistëve	Trajnohet stafi; dy konsultime/vit me sportistë e klube; dokumentohen propozimet dhe përgjigjet.	SP; përfaqësuesit e sportistëve	Qershor/dhjetor çdo vit	FGJK; KOK	2 trajnime stafi dhe 2 konsultime/vit; përgjigje ndaj propozimeve brenda 30 ditësh.
5.6 Monitorimi dhe vlerësimi	Përditësohet regjistri i veprimeve; bëhen shqyrtime tremujore, vlerësim i ndërmjetëm dhe përfundimtar.	SP; BE; vlerësues i jashtëm	Mujor; ndërmjetëm 31.03.2029; final 31.03.2031	FGJK; vlerësues	12 raporte mujore



OS6: Financim i qëndrueshëm

Gjendja aktuale 2026	Përshkrimi	Synimi 2030	KPI
Plani i vjetër identifikon nevojën për financim dhe marketing. Të ardhurat 2026 dhe ndarja sipas burimit verifikohen në regjistrin financiar.	Diversifikimi i të ardhurave, partneritete me rezultat praktik dhe komunikim publik që e lidh mbështetjen me rezultate të dokumentuara.	≥30% e të ardhurave monetare nga burime jopublike në 2030; 5 sponsorë aktivë; 3 partneritete ndërkombëtare aktive; ≥1 aktivitet pritës ndërkombëtar.	Pjesa jopublike; sponsorë me pagesë; partneritete me aktivitet; fonde të konfirmuara kundrejt kostove.

Treguesi	2027	2028	2029	2030
Të ardhura monetare jopublike	≥10%	≥15%	≥20%	≥30%
Sponsorë aktivë në vit	2	5	5	5
Partneritete ndërkombëtare aktive	1	2	3	3
Aktivitete ndërkombëtare që gjenerojnë të ardhura vetanake për FGJK-në	1	3	6	7

Plani i veprimit për OS6

Veprimi Çfarë	Detyrat Si	Përgjegjës	Afati	Burimet	KPI dhe masa e suksesit
6.1 Plani i financimit dhe aplikimet	Përgatiten buxheti, kalendari i thirrjeve dhe dosjet për ministrinë, KOK-un, FIG-në dhe sponsorët apo donatorët.	SP; financieri; Kryetari	31.01 çdo vit; aplikime sipas thirrjeve	FGJK; staf	≥4 aplikime të plota/vit; % e financimeve të pranuara
6.2 Sponsorët dhe të ardhurat jopublike	Përgatiten 3 paketa; realizohen takime dhe raportohet përdorimi i kontributeve në para.	Kryetari; përgjegjësi i marketingut	Paketat 31.03.2027; marrëveshje deri 31.12 çdo vit	FGJK; sektor privat 4 800 €	≥10 takime/vit; ≥2 sponsorë aktivë në 2027, ≥3 në 2028, ≥4 në 2029 dhe ≥5 në 2030; pjesa jopublike e të hyrave arrin 30% në 2030.
6.3 Partneritetet ndërkombëtare	Negociohen kampe, mentorim dhe shkëmbime me federata;	Kryetari dhe SP	1 deri 2027; 2 deri 2028; 3 deri 2029	FGJK; federata partnere 3 200 €	3 marrëveshje aktive nga 2029, secila me ≥1 aktivitet të përfunduar/vit.
6.4 Komunikimi dhe identiteti publik	Përgatitet kalendari; publikohen rezultatet, mundësitë e edukimit dhe programet për fëmijët.	SP; përgjegjësi i komunikimit	Plan 31.03.2027; zbatim mujor	FGJK;	≥4 publikime/muaj; çdo garë me përmbledhje brenda 7 ditësh; analitikë tremujore.
6.5 Aktiviteti pritës ndërkombëtar	Përgatitet studimi i kapacitetit; ftohen partnerë vetëm pas konfirmimit të buxhetit dhe sigurisë.	BE; ST dhe SP	Studim 31.12.2028; aktivitet deri 30.11.2029	FGJK; partnerë; sponsorë 6 500 €	1 kamp ose garë me pjesëmarrje nga ≥3 shtete gjithsej; raport teknik dhe financiar.
6.6 Vlerësimi i partnerëve	Mblidhen reagimet dhe përgatitet raporti i ndikimit për sponsorët; negociohet vazhdimësia para skadimit.	SP; marketingu	Deri 30.11 çdo vit	FGJK;	100% e partnerëve marrin raport; ≥60% e sponsorëve të vitit paraprak e vazhdojnë marrveshjen

Shkurtesat:
FGJK - Federata e Gjimnastikës së Kosovës;
BE - Bordi Ekzekutiv;
SP - Sekretari i Përgjithshëm;
ST - Sekretari teknik;
KOK - Komiteti Olimpik i Kosovës;
FIG - federata ndërkombëtare e gjimnastikës (World Gymnastics);
EG - European Gymnastics;
KPI - tregues kyç i performancës.